



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Illir Halili</b>	<b>25.03.2026</b>	<b>08.04.2026</b>	<b>2026/0180</b>

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.03.2026, OE “Company Murseli SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0180, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-11613-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrat?s:sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrates: [124,212.00](#)

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

e dt.27.02.2026 kemi marr njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku është anuluar aktiviteti i prokurimit, ndërsa

ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin:

Dëshmi 1 OE duhet të ofrojë listën e makinerisë të kërkuara për ekzekutim të shërbimeve

e vulosur dhe nënshkruar, si ne vijim:

punëve

1.Bager me lugë min. 18 ton -2 c?p?

2. Bulldozer me goma min.30 ton -I cop?

3. Eskavator për hapjen e kanaleve min.25 ton -2 copë

4. Kamion transportues të peshave të rënda min.35 ton

5. Vinç për pesha të rënda min. 12 tonë

-2 copë

-1 copë

6. Kamion me kran për ngarkimin e kontejnerëve min.5 tonë - 1 copë

7. Autobartëse kran për transportimin e automjeteve të pa lëvizshme me peshë bartëse min. 10 tonë

-1 copë

8. Lygë ngarkuese min.25 ton -1 cop?

9. Eskavator me lopatë dhe pirunier teleskopik -1 copë

Të dëshmohet me librezë valide për makineritë (nëse regjistrohet makineria) nëse OE nuk i ka pronësi të dëshmojen kontrata marrëveshja për marrjen me qira. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar.

Ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate është kërkuar kriter: Operatori Ekonomik duhet te ofrojë listën mbi makineritë e nënshkruar dhe vulosur nga OE për makineritë si në vijim:

1. Bager me lugë min. 18 ton -2 copë

2. Bulldozer me goma min.30 ton -1 copë

3. Eskavator për hapjen e kanaleve min.25 ton -2 copë

4. Kamion transportues të peshave të rënda min.35 ton

5. Vinç për pesha të rënda min. 12 tonë

-2 copë

-1 copë

6. Kamion me kran për ngarkimin e kontejnerëve min.5 tonë - 1 copë

7. Autobartëse kran për transportimin e automjeteve të pa lëvizshme me peshë bartëse min.10 tonë

-1 copë

8. Lygë ngarkuese min.25 ton -1 c?p?

9. Eskavator me lopatë dhe pirunier teleskopik -1 copë

OE ka dorëzuar listën e pajisje ka dorëzuar edhe marrëveshjet por marrëveshjet e dorëzuar nuk janë të noterizuar sipas kriterit të kërkuar në FDT.

AK kërkon sqarime në për marrëveshjet e noterizuar por OE edhe pas përgjigjeve nuk arrin ta plotësojë kriterin e kërkuar në FDT. Andaj oferta juaj refuzohet si pa përgjegjshmë.

Në lidhje me arsyen e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit, ju sqarojmë se në kemi ofruar listën e

makinerive, e po ashtu kemi ofruar edhe marrëveshjet për shfrytëzim të makinerive, prandaj kjo është me

rëndësi dhe fakt që e përmbush qëllimin e kërkesës së dosjes së tenderit.

Autoriteti kontraktues na ka kërkuar sqarime shtesë në lidhje me listën e marrëveshjeve për marrjen me qira

të makinerive me dt.10.02.2026, ndërsa ne i kemi ofruar sqarimet në lidhje me kërkesën me sqarime me

dt.13.02.2026, ku kemi sqaruar se marrëveshjet janë valide dhe të nënshkruara nga palët përkatëse

përkatësisht qiradhënësi dhe qiramarrësi. Po ashtu e kemi inkurajuar autoritetin kontraktues që nëse ka ndonjë

dilemë në lidhje me këto makineri, që të dalin në terren dhe ti verifikojnë ato.

Ne edhe pse i kemi ofruar sqarimet të cilat i ka kërkuar autoriteti kontraktues, përsëri jemi eliminuar me

arsyetimin se marrëveshjet nuk janë ofruar të noterizuara.

4

me

Sa i përket arsyes së eliminimit tonë, ne edhe një herë po e sqarojmë se marrëveshjet për qira të makinerive

ne i kemi të nënshkruara me kompanitë përkatëse të ndryshme. Këto marrëveshje janë të nënshkruara

vullnet të plotë të palëve, prandaj janë të plotfuqishme dhe nga origjinali i marrëveshjeve janë skenuar këto

dokumente dhe janë bashkëngjit me ofertë.

Sa i përket Noterizimit të marrëveshjeve për makineri, edhe në kërkesë për sqarime e kemi sqaruar se ne nuk

i kemi noterizuar ato marrëveshje duke u bazuar në nenin 26.16 të RREGULLORE NR.002/2024 PER PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PER PROKURIMIN PUBLIK, ku

cekete që "Autoriteti Kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacion të dorëzuar nga Operatori Ekonomik, do të kryej një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit tek autoriteti /  
personi fizik përkatës dhe rrjedhimisht kërkesa e Autoritetit Kontraktues për noterizim të dokumenteve konsiderohet e panevojshme".

Ne e kemi sqaruar qartë, se nëse eventualisht autoriteti kontraktues ka ndonjë dyshim tek dokumentet tona,

atëherë lirisht mund të kryhet një kontroll efektiv i dokumenteve dhe informatave konform nenit 52.7 të LPPsë.

Marrëveshjet për makineri të prezantuara nga ana jonë, janë valide dhe makineritë mund të shfrytëzohen pa

asnjë problem për këtë projekt, ndërsa me dosje kemi bashkëngjitur marrëveshjet e skanuara nga origjinali,

prandaj me mirëkuptim kemi kërkuar që të merren parasysh këto fakte gjatë vlerësimit të dokumenteve ose

në të kundërtën të bëhet kontroll efektiv i këtyre dëshmimeve. Ne kemi qenë të gatshëm edhe marrëveshjet e

nënshkruara origjinale ti ofrojmë fizikisht tek autoriteti kontraktues e jemi të gatshëm edhe tek OSHP-ja ti

dorëzojmë nëse është e nevojshme.

Eliminimi ynë është mbështetur pikërisht në mungesën e noterizimit të marrëveshjeve për shfrytëzim të makinerive edhe përkundër faktit se këto marrëveshje janë dorëzuar të nënshkruara nga palët kontraktuese

dhe të njëjtat dëshmojnë qartë disponueshmërinë e makinerive për realizimin e kontratës. Mungesa e noterizimit kur kemi parasysh edhe dispozitën e nenit 26.16 të RRPP Nr.002/2024, në asnjë mënyrë nuk e

cenon vlefshmërinë juridike të marrëveshjeve, nuk ndryshon përmbajtjen e ofertës sonë dhe as nuk ndikon

në aftësinë tonë për realizimin e projektit. Andaj kur kemi parasysh këto fakte, konsiderojmë se eliminimi

për një çështje të tillë formale, e cila nuk prek substancën dhe qëllimin e kërkesës dhe është lehtësisht e verifikueshme, është eliminim i pa bazuar dhe për më tepër tendencioz, pasi që AK-ja nuk ka shpreh fare

gatishmëri të kryej një kontroll efektiv të këtyre dokumenteve.

Në nenin 26.16 të RRPP Nr.002/2024 po përcaktohet qartë se kërkesa e AK-së për noterizim të dokumenteve

konsiderohet e panevojshme, prandaj edhe në këtë rast edhe nëse ofrohet marrëveshjet e noterizuar nuk është

që fuqizojnë marrëveshjet pasi që marrëveshjet janë lidh me vullnet të lirë të palëve dhe nuk ka pas asnjë

kontestim nga ndonjëri prej këtyre nënshkruesve të marrëveshjeve, prandaj nuk ekziston asnjë arsye që të

mos merren parasysh marrëveshjet e nënshkruara dhe të vulosura nga palët, pavarësisht që nuk janë të noterizuara. Pra mungesa e noterizimit të këtyre dokumenteve nuk ndikon absolutisht në përmbajtjen apo

vlefshmërinë e marrëveshjeve, e po ashtu disponueshmëria e pajisjeve nuk vihet në dyshim.

Noterizimi i këtyre dokumenteve, nuk do të thotë asgjë më shumë se sa formalizim i nënshkrimeve, e të cilat

nënshkrime nuk janë të kontestuara nga asnjë palë nënshkruese, prandaj për derisa nuk ka kontestime atëherë

qartë kuptohet se mjetet dhe pajisjet janë në dispozicion për këtë projekt dhe nuk ka asnjë pengesë për të ecur

më tutje me këtë procedurë prokurimi.

Mos noterizimi i marrëveshjeve mund të konsiderohet eventualisht devijim i vogël sipas nenit 59.4 pika (ii)

të LPP-së ku shkruan që tenderi mund të konsiderohet i përgjegjshëm pavarësisht nëse "përmban vetëm 5

devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat,

kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që,

çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe

krahasimit të tenderëve"

Ne kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt.12.03.2026, mirëpo që nuk është

dhënë ndonjë arsye konkrete për këtë refuzim.

Edhe në këtë vendim për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, autoriteti kontraktues vetëm i ka përsëritur arsyet e eliminimit dhe qëndrimet e saja mirëpo nuk ka ofruar asnjë argument apo provë për të

kundërshtuar

pretendimet tona ankimore.

Për më tepër, autoriteti kontraktues i ka përshkruar dispozitat që ne kemi pretenduar se nuk janë respektu dhe

konstaton se ne nuk i kemi plotësuar kriteret administrative, gjë që është e pasaktë dhe e pavërtetë.

Pretendimi i AK-së, se edhe pas sqarimeve ne nuk kemi arrit të dëshmojmë dokumentet sipas njoftimit për

kontratë është pretendim jo real dhe jo i vërtetë, pasi që ne e kemi dëshmuar edhe me kërkesë për rishqyrtim

se marrëveshjet janë valide të nënshkruara dhe plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit përkitazi me qëllimin

e kësaj kërkesë.

Për derisa makineritë janë në dispozicion, e ku dëshmi janë marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet qiramarrësit

dhe qiradhënësit atëherë nuk ka asnjë arsye që mungesa e noterizimit të konsiderohet devijim i vogël sipas

nenit 59.4 të LPP-së.

Në këtë rast shtrohet një pyetje konkrete, cila është arsyeja e noterizimit të këtyre marrëveshjeve?

Nëse autoriteti kontraktues ka dilema më të vërtetë në lidhje me këto marrëveshje, atëherë është dashur të ju

shkruaj dhe ti kontaktojë kompanitë qiradhënëse apo edhe të dalin në vend të ngjarjes ti verifikojnë këto

pajisje. Pra, ka mekanizma ligjore për verifikim të këtyre dëshmimeve por që AK-së nuk e ka ndërmarr asnjërin

veprim për të qartësuar këto marrëveshje dhe ne konsiderojmë se arsyeja përse nuk janë ndërmarr këto

veprime është se vetë AK-së e ndjen dhe e din se marrëveshjet janë valide dhe të plotfuqishme.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi

i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe

kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni

60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që fondet

publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë

qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Në këtë tender, ne kemi qenë ofertuesi me çmimin më të lirë dhe kemi plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit,

prandaj arsyeja e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit është në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe

me nenin 43.5 dhe 43.7 të RRPP Nr.001/2022, sepse nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara

në këto dispozita ligjore.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, konsiderojmë se ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes

së tenderit dhe është dashur të rekomandohemi për kontratë, ndërsa me këtë rast AK-ja nuk ka respektuar

edhe paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së ku përcaktohet qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët

6

ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojnë në mënyrë transparente", ndërsa

ne jemi diskriminuar duke u eliminuar pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë dëshmi konkrete.

Pra, ne jemi diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, prandaj kërkojmë nga AK-së që të bëjë edhe

një herë rishqyrtimin e ofertës tonë sepse i plotësojmë të gjitha kërkesat substancialisht dhe duhet të rekomandohemi për kontratë.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi

i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve

publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP, që të merr:

VENDI?

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE COMPANY MURSELI SH.???,

ANULOHEM, njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në

RIVLERESIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni

me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet

tjera kompetente

#### KRITERET PËR VLERËSIM

Dosja e tenderit - FDT- Marrveshjet e noterizuara

#### RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK)

Ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë është kërkuar kriter : Operatori Ekonomik duhet të ofrojë listën mbi makineritë e nënshkruar dhe vulosur nga OE për makineritë si në vijim:

- 1.Bager me lugë min.18 ton -2 copë
- 2.Bulldozher me goma min.30 ton -1 copë
- 3.Eskavator për hapjen e kanaleve min.25 ton -2 copë
- 4.Kamion transportues të peshave të rënda min.35 ton -2 copë
- 5.Vinç për pesha të rënda min.12 tonë -1 copë
- 6.Kamion me kran për ngarkimin e kontejnerëve min.5 tonë - 1 copë
- 7.Autobartëse kran për transportimin e automjeteve të pa lëvizshme me peshë bartëse min.10 tonë -1 copë
- 8.Lygë ngarkuese min.25 ton -1 copë
- 9.Eskavator me lopatë dhe pirunier teleskopik -1 copë

Dëshmi 1 OE duhet të ofrojë listën e makinerisë të kërkuara për ekzekutim të shërbimeve punëve e vulosur dhe nënshkruar, si ne vijim :

- 1.Bager me lugë min.18 ton -2 copë
- 2.Bulldozher me goma min.30 ton -1 copë
- 3.Eskavator për hapjen e kanaleve min.25 ton -2 copë
- 4.Kamion transportues të peshave të rënda min.35 ton -2 copë
- 5.Vinç për pesha të rënda min.12 tonë -1 copë
- 6.Kamion me kran për ngarkimin e kontejnerëve min.5 tonë - 1 copë
- 7.Autobartëse kran për transportimin e automjeteve të pa lëvizshme me peshë bartëse min.10 tonë -1 copë
- 8..Lygë ngarkuese min.25 ton -1 copë
- 9.Eskavator me lopatë dhe pirunier teleskopik -1 copë

Të dëshmohet me librezë valide për makineritë ( nëse regjistrohet makineria) nëse OE nuk i ka pronësi të dëshmohen kontrata marrëveshja për marrjen me qira. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar.

#### **B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

OE ka dorëzuar listën e pajisje ka dorëzuar edhe marrëveshjet por marrëveshjet e dorëzuar nuk janë të noterizuar sipas kriterit të kërkuar ne FDT.

AK kërkon sqarime ne për marrëveshjet e noterizuar ,por OE edhe pas përgjigjeve nuk arrin ta plotësojë kriterin e kërkuara ne FDT.Andaj oferta juaj refuzohet si pa përgjegjshme.

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

--

### VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

--

### VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

--

### ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

--

### PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Company Murseli SH.P.K.

#### Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës 180/26 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues nga AK, ku sipas AK-së i njëjti për pajisjet që nuk janë në pronësi të OE, marrveshjet për marrje me qera me kompani tjera nuk i ka noterizuara.

OE ankues pretendon se edhe pse marrveshjet nuk janë të noterizuara ato janë valide dhe duhet të pranohen si të tilla.

OE ndër të tjera në ankesë potnecon se"

*"Autoriteti kontraktues na ka kërkuar sqarime shitesë në lidhje me listën e marrëveshjeve për marrjen me qira të makinerive me dt.10.02.2026, ndërsa ne i kemi ofruar sqarimet në lidhje me kërkesën me sqarime me dt.13.02.2026, ku kemi sqaruar se marrëveshjet janë valide dhe të nënshkruara nga palët përkatëse përkatësisht qiradhënësi dhe qiramarrësi. Po ashtu e kemi inkurajuar autoritetin kontraktues që nëse ka ndonjë dilemë në lidhje me këto makineri, që të dalin në terren dhe ti verifikojnë ato. Ne edhe pse i kemi ofruar sqarimet të cilat i ka kërkuar autoriteti kontraktues, përsëri jemi eliminuar me arsyetimin se marrëveshjet nuk janë ofruar të noterizuara. 4 me Sa i përket arsyes së eliminimit tonë, ne edhe një herë po e sqarojmë se marrëveshjet për qira të makinerive ne i kemi të nënshkruara me kompanitë përkatëse të ndryshme. Këto marrëveshje janë të nënshkruara vullnet të plotë të palëve, prandaj janë të plotfuqishme dhe nga origjinali i marrëveshjeve janë skenuar këto dokumente dhe janë bashkëngjit me ofertë".*

Eksperti shqyrtues jep mendim se kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë e qartë, se marrëveshjet me kompani tjera DUHET të jenë të noterizuara, andaj pretendimi ankimorë sipas mendimit të ekspertit është i pabazuar.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Company Murseli SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA**” me numër të prokurimit: “**214/30400-25-11613-2-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Company Murseli SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA**” me numër të prokurimit: “**214/30400-25-11613-2-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Company Murseli SH.P.K.**

